 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
BU-REG-012-AL	01.10.2012	-	-	1 / 13	

KREU 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Rregullorja e studimeve master i shkencave në psikologji këshillimi dhe pedagogji përcakton parimet e funksionimit të këtij programi.

Neni 2

Baza Ligjore

Rregullorja e Programeve të Studimit të Ciklit të Dytë të Shkollës së Lartë “ Hëna e plotë” (Bedër) mbështetet në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10307, datë 22.07.2010 “Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në licencën e dhënë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 6.4.2011, “Për licencimin e Institucionit Privat të Arsimit të Lartë “Shkolla e Lartë “Hëna e plotë” (Bedër), në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 14, datë 03.04.2008 “Për hapjen dhe organizimin e programeve të studimit të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 15, datë 04.04.2008 “Për organizimin e studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë” si dhe në Statutin dhe Rregulloren Themelore të këtij institucioni.

KREU 2

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT


Neni 3

Objektivat formues specifikë të programit

Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, si dhe Deklaratës së Bolonjës, studentët që mbarojnë studimet në ciklin tre-vjeçar mund të vazhdojnë studimet e tyre në Ciklin e Dytë “Master i Shkencave” apo “Master Profesional”.

Programi “Master i Shkencave” në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji, ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e këshillimit psikologjik individual dhe në grup si dhe në fushën e pedagogjisë, etj.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)			
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit
	01.10.2012	-	-	2 / 13

Të diplomuarit e këtij program studimi do të kenë përparësi në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë, si dhe do të kenë akoma më shumë përparësi në shkallët e karrierës drejt kërkimeve shkencore në fushën e këshillimit individual dhe këshillimit në grup.

Synimet kryesore të programit janë:

- të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t’u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë;
- të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë;
- të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në profesionin e psikologut për të ndihmuar shoqërinë në tërësi;
- të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion;
- të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës;
- të mundësojë një kualifikim shkencor të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të psikologjisë dhe pedagogjisë në tërësi;
- të krijojë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;


Këto synime do të sendërtohen në objektivat e përgjithshme që ka ky program studimi, si:

- t’u japë të diplomuarve arsimimin e duhur dhe trajnimin e thelluar në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë;
- t’u krijojë atyre një vizion të ri për këshillimin psikologjik në Shqipëri, në përputhje me përvojën e krijuar të plotësuar me konceptet evropiane;
- të përpiqet për të realizuar një status të ri të psikologut në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore që janë krijuar në ditët e sotme;
- programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e këshillimit psikologjik në bazë të strategjisë kombëtare si dhe të japë ndihmesën e vet për krijimin e nje elite të re të fushës së psikologjisë dhe pedagogjisë.

Neni 4 Organizimi i Studimeve

Studimet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” në program studimin Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji zhvillohet në sistemin me kohë të plotë.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	3 / 13

Programi i studimeve realizohet me 120 ECTS, në përputhje me planin mësimor propozuar nga departamenti i Shkencave të Edukimit dhe vendim i Këshillit të Administrimit të Fakultetit dhe miratur me vendim të Senatit Akademik të Shkollës së Lartë “Hëna e plotë - BEDER”.

Neni 5 Gjuha e Studimeve

Gjuha e studimit në programin “Master i Shkencave” në program studimin Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji është gjuha angleze.

Neni 6 Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese

Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtarive të tjera formuese të programit është si më poshtë:

T - Orë Teorike

P - Orë Praktike

K - Kredite sipas Sistemit Amerikan

ECTS - Kredite sipas Sistemit ECTS

Programi master i shkencave në psikologji këshillimi dhe pedagogji:

PLANI MESIMOR MASTER PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI

Semestri I									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	PSD 403	Metodat e Hulumtimit në Shkencat Sociale	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
2	PSD 413	Teoritë dhe Teknikat e Këshillimit	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
3		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
4		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
Gjithsej						320	430	17.5	30

Semestri II									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË-BEDËR

RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	4 / 13

1	PSD 404	Përgasjet Multikulturore në Arsim	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
2	PSD 416	Këshillim Shkollor	E detyruar	Anglisht	B	64	86	3.5	6
3		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
4		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
Gjithsej						320	430	17.5	30

Semestri III									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
2	PSD 511	Seminar Pasuniversitar	E detyruar	Anglisht	B	80	170	4	10
3	PSD 535	Praktikë Shkollore	E detyruar	Anglisht	B	80	120	4	8
4		Lëndë me Zgjedhje	Me Zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
5		Lëndë me Zgjedhje	Me Zgjedhje	Anglisht	D	80	70	4	6
Gjithsej						320	430	16	30

Semestri IV									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	PSD 610	Tezë	E detyruar	Anglisht	F	320	430	10	30
Gjithsej						320	430	10	30

Lëndët me zgjedhje									
Nr.	Kodi i lëndës	Lënda	Lloji i lëndës	Gjuha	Grupi i lëndës	Leksione / Seminare	Punë Individuale	Kredi	ECTS
1	PSD 401	Zhvillimi i Personalitetit	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
2	PSD 437	Kultura dhe Diversiteti	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
3	PSD 471	Psikologji Zhvillimi	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
4	PS D 418	Statistikat Inferencial e në Arsim	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË-BEDËR

**RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË
PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË
LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	5 / 13

5	PS D 428	Aspektet Psikologjike në Edukimin e Vecantë	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
6	PS D 427	Zbatime në Këshillim dhe Udhëheqje Profesionale	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
	EDU 413	Teori të Mësimdhënies dhe Mësimnxënies	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
8	EDU 401	Bazat e Pedagogjise	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
9	EDU 421	Menaxhimi dhe Udhëheqja e Klasës	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
10	PSD 420	Këshillim në Familje	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
11	PS D 432	Vlerësim i Zhvillimit Konjitiv	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
12	EDU 404	Zhvillimi dhe Udhëzimi i Kurrikulës	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
13	EDU 422	Metodologjia e Mësimdhënies në Shkenca	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
	EDU 432	Metodologjia e Mësimdhënies në Shkenca Sociale	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
15	EDU 442	Metodologjia e Mësimdhënies së Gjuhëve	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË-BEDËR

RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	6 / 13

16	PSD 521	Këshillim në Grup	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
17	PS D 543	Komuniteti dhe Këshillimi	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6
18	PS D 551	Ndërhyrje në Sjelljet Shkollore	Me zgjedhje	Anglisht	D	64	86	3.5	6

PLANI MËSIMOR SIPAS TIPIT TË VEPRIMTARISË “MASTER I SHKENCAVE” NË PROGRAM – STUDIMIN PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI

Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Lënda/Moduli	Kreditet	Totali
Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A)			
Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B)	Përqasjet multikulturore në arsim	6	42
	Këshillim shkollor	6	
	Teoritë dhe teknikat e këshillimit	6	
	Praktikë shkollore	8	
	Seminar pasuniversitar	10	
	Metodat e hulumtimit në shkencat sociale	6	
Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C)			
Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	Zhvillimi i Personalitetit	6	108
	Kultura dhe Diversiteti	6	
	Psikologji Zhvillimi	6	
	Statistikat Inferenciale në Arsim	6	
	Aspektet Psikologjike në Edukimin e Vecantë	6	
	Zbatime në Këshillim dhe Udhëheqje Profesionale	6	
	Teori të Mësimdhënies	6	

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË-BEDËR


**RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË
PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË
LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	7 / 13

Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D)	dhe Mësimnxënies		
	Bazat e Pedagogjise	6	
	Menaxhimi dhe Udhëheqja e Klasës	6	
	Këshillim në Familje	6	
	Vlerësim i Zhvillimit Konjitiv	6	
	Zhvillimi dhe Udhëzimi i Kurrikulës	6	
	Metodologjia e Mësimdhënies në Shkenca	6	
	Metodologjia e Mësimdhënies në Shkenca Sociale	6	
	Metodologjia e Mësimdhënies së Gjuhëve	6	
	Këshillim në Grup	6	
	Komuniteti dhe Këshillimi	6	
	Ndërhyrje në Sjelljet Shkollore	6	
Njohuri të tjera formuese si plotësime në gjuhët e huaja, informatikë, stazh, apo praktika (E)			
Teza e Diplomës (F)	Tezë	30	30
Totali			180

Formim i përgjithshëm: 0 ECTS
 Formimi bazë: 42 ECTS
 Lëndët me zgjedhje: 108 ECTS
 Mikroteza: 30 ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	8 / 13

Neni 7

Kompetencat dhe objektivat formuese të veçanta të çdo veprimtarie formuese

Kompetencat dhe objektivat formues të çdo lënde, pjesë e kurrikulës mësimore, parashikohen në syllabuset respektivë.

Neni 8

Kreditet dhe detyrimet penguese për cdo disiplinë mësimore apo veprimtari tjetër formuese

Programet e studimit të ciklit të parë, që mundësojnë pranimin në Programin Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji:

a. Pa plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	0 Kredite

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Kredite për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët nuk kërkohet plotësim i njohurive formuese	1. Psikologji shkollore	0 Kredite
	2. Psikologji	0 Kredite
	3. Pune sociale	0 Kredite
	4. Pedagogji	0 Kredite
	5. Programe të ngjashme studimi	0 Kredite

b. Me plotësim të njohurive formuese para hyrjes në program:

Nga i njëjti institucion i arsimit të lartë		Lëndët	Kredite për t'u plotësuar

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë



SHKOLLA E LARTË
HËNA E PLOTË-BEDËR


**RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË
PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË
LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)**

Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
	01.10.2012	-	-	9 / 13

Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Departamenti i Shkencave të Edukimit	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
	Programi Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji	2. Psikologji e Edukimit	5 ECTS
	Programi Arsim Parashkollor dhe Fillor	3. Menaxhim i Klasës	5 ECTS
	Departamenti i Shkencave të Komunikimit	4. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
	Departamenti i Shkencave Islame	5. Edukimi Special	5 ECTS
	Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Turke	6. Filozofia dhe Teoria e Edukimit	5 ECTS
Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze			5 ECTS
Totali		6 Lëndë	30 ECTS

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Psikologji	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
	Psikologji shkollore	2. Menaxhim i Klasës	5 ECTS
	Punë sociale	3. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
		4. Edukimi Special	5 ECTS
		5. Filozofia dhe Teoria e Edukimit	5 ECTS
Totali		5 Lëndë	25 ECTS

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	10 / 13

Nga institucione të tjera të arsimit të lartë		Lëndët	Kreditë për t'u plotësuar
Programi apo programet e ciklit të parë për të cilët kërkohet plotësim i njohurive formuese, shoqëruar me numrin e krediteve për t'u plotësuar	Shkenca Natyrore Ekonomi Gazetari Programe të ngjashme studimi	1. Parimet e Këshillimit dhe Pedagogjisë	5 ECTS
		2. Psikologji e Edukimit	5 ECTS
		3. Menaxhim i Klasës	5 ECTS
		4. Çështjet Etike, Ligjore dhe Profesionale në Këshillim	5 ECTS
		5. Edukimi Special	5 ECTS
		6. Filozofia dhe Teoria e Edukimit	5 ECTS
		7. Hyrje në Pedagogji	5 ECTS
Totali		7 Lëndë	35 ECTS

Neni 9

Njohja e krediteve për njohuri të fituara më parë

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Komiteti Shkencor mund të njohë si kredite të formimeve universitare në Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji deri në 40 kredite të njohurive të veprimtarive formuese të fituara më parë nga studenti, të cilat janë në përputhje me objektivat specifike të programit.

Neni 10

Forma e studimit, provimet dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studentët


Programi përbëhet nga 14 lëndë dhe teza e diplomës, e cila zhvillohet në përfundim të programeve të studimit të ciklit të dytë.

Në një vit akademik realizohen të paktën 60 kredi ECTS.

1 vit akademik ka 32 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve

1 semestër ka 16 javë mësimore në auditor, përfshirë edhe javën e provimeve

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)				
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit	Faqe/Total
		01.10.2012	-	-	11 / 13

1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

1 orë mësimore = 60 minuta

Studenti realizon çdo vit jo më pak se 1500 orë pune.

Programi organizohet në dy vite akademike, i ndarë në katër semestra

Një vit akademik ka 60 ECTS

Procesi mësimor përbëhet nga leksionet dhe seminarët të cilat jepen në mënyrë të integruar,, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme të parashikuara në programin mësimor.

Vlerësimi nga pikëpamja akademike për leksionet/seminarët, projektet/detyra, dhe punime të tjera të ngjashme bëhet në bazë të njësisë matëse orë të zhvilluar në auditor. Vlera e krediteve të një lëndë përbëhet nga shuma e të gjithë orëve javore të leksioneve teorike javore dhe sa gjysma e orëve javore të aplikimeve, laboratoreve, projekteve dhe punës në atelje.

Niveli i suksesit të studentit vlerësohet mbi bazën e provimeve semestrale/vjetore; provimeve të fundvitit; detyrave të kursit; prezantimeve; aktivizimeve dhe projekteve. Me propozim të drejtuesit të programit përkatës dhe vendim të Komitetit Shkencor, studentit i jepet e drejta të hyjë në provim nëse nuk ka hyrë gjatë vitit për shkaqe të arsyeshme dhe të dokumentuara brenda tre ditëve.

Neni 11 Frekuentimi

Studenti në program ka detyrimin të ndjekë të paktën 70% të aktiviteteve mësimore kërkimore të zhvilluara në auditor të lëndëve teorike dhe të aktiviteteve mësimorë kërkimore. Studentët të cilët tejkalojnë këto norma duhet ta rimarrin përsëri atë lëndë me të gjitha detyrimet përkatëse.

Plotësimi apo jo i kushteve në lidhje me pjesëmarrjen, i paraqitet koordinatorit të programit nga ana e pedagogut të lëndës çdo muaj dhe kontrollohet nga Përgjegjësi i Departamentit.


Neni 12 Transferimi i studentëve

Kuotat për transferimet në Programin Master i Shkencave në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji përcaktohen nga Komiteti Shkencor dhe miratohen nga Këshilli i Administrimit të Fakultetit, duke u bazuar në parimet e vendosura nga ky Këshill.

Studentët të cilët studiojnë në programe të Ciklit të Dytë ose ekuivalentë me to, brenda dhe jashtë Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë – BEDER”, mund të aplikojnë për t’u transferuar në programet e Ciklit të Dytë të në programin e studimit “Master i Shkencave” në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji.

Studentët që kanë kryer një semestër në një program të studimit të Ciklit të Dytë, mund të aplikojnë pranë sekretarisë mësimore brenda afateve të caktuara në kalendarin akademik, për t’u transferuar në

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)			
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit
	01.10.2012	-	-	12 / 13

Programin “Master i Shkencave” në *Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji*, në përputhje me parimet e vendosura nga ana e Senatit.

Studenti që dëshiron të transferohet në programin “Master i Shkencave” në *Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji*, për programet e studimit brenda Shkollës së Lartë “Hëna e Plotë – BEDER” duhet që përveç plotësimit të të gjitha kriterëve të përcaktuara për pranimin në programet e Ciklit të Dytë, t’i paraqesë një kërkesë me shkrim Komitetit Shkencor të këtij programi, ku të parashtrijë kërkesën për njohjen e krediteve të fituara në programin pararendës.

Studenti që dëshiron të transferohet në programin “Master i Shkencave” në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji nga institucione të tjera të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, duhet që përveç plotësimit të kriterëve të mësipërme, bashkë me kërkesën e aplikimit për transferim, të paraqesë një dokument zyrtar me notat përkatëse dhe brendësinë e lëndëve të zhvilluara.

Pas dorëzimit të dokumentacionit të mësipërm, Komiteti Shkencor i programit shqyrton kërkesën për njohjen e krediteve dhe bën vlerësimin e përputhshmërisë së programeve mësimore në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesi dhe merr vendimin përkatës.

Studentëve të cilët janë transferuar në këtë program u jepet diplomë me kushtin që të kenë kryer të paktën një semestër në Shkollën e Lartë “Hëna e plotë – BEDER”.

Neni 13 Numri i studentëve

Numri minimal i studentëve në Programin Master i Shkencave në psikologji këshillimi dhe pedagogji është gjashtë dhe ai maksimal është pesëdhjetë.


Neni 14 Kushtet e pranimit

Për t’u pranuar në programin e studimeve “Master i Shkencave” në Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji çdo shtetas shqiptar apo i huaj që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit Bachelor. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit Bachelor në programin e studimit Psikologji Këshillimi dhe Pedagogji ose të ngjashëm me këtë program.

Neni 15 Vlerësimi i stafit akademik

Vlerësimi i titujve të stafit akademik është kompetencë e departamentit të Shkencave të Edukimit dhe bëhet me procedura publike.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

 SHKOLLA E LARTË HËNA E PLOTË-BEDËR	RREGULLORE E STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË PSIKOLOGJI KËSHILLIMI DHE PEDAGOGJI E SHKOLLËS SË LARTË “HËNA E PLOTË” (BEDËR)			
	Kodi i dokumentit	Data e publikimit	Nr. i përditësimit	Data e përditësimit
	01.10.2012	-	-	13 / 13

Neni 16

Udhëheqja e Tezës

Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.

Udhëheqësi i tezës ka të paktën gradën shkencore “Doktor”.

Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane. Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit. Udhëheqësi ka njohuri të përparuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.

Neni 17

Niveli i Gjuhës Angleze

Studentët e programit të studimit në fjalë japin deri në diplomim provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të Ciklit të Dytë niveli i gjuhës angleze është C1, kjo sipas Kuadrit Evropian të Gjuhëve.

KREU 3

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Zbatimi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit të saj në Këshillin e Lartë të Shkollës së Lartë.

Zbatimi i kësaj rregulloreje sigurohet nga Rektori.

Njësia përpiluese	Njësia kontrolluese	Njësia miratuese
Senati	Këshilli i vlerësimit akademik dhe zhvillimit të cilësisë	Këshilli i lartë

